

UDHËZUES  
PËR MONITORIMIN E PROCESIT TË  
INTEGRIMIT EUROPIAN - KAPITULLI 24:  
DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA





---

**PUBLIKUES**

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)  
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3. (Dora D'Istria)  
Tel: +355 44 104 247  
E-mail: info@em-al.org  
Web: www.em-al.org

**AUTOR/E**

Geron KAMBERI

**VITI I PUBLIKIMIT:**

2025

---

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



---

HYRJE	03
-------	----

---

KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA	05
---	----

---

MONITORIMI I NËNKAPITUJVE TË KAPITULLIT 24	09
• Lufta kundër krimit të organizuar	09
• Lufta kundër terrorizmit	11
• Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës	13
• Migracioni i rregullt dhe i parregullt	14
• Azili	16
• Politika e Vizave, Shengen dhe kufijtë e jashtëm të BE	17
• Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale e civile	18

---

MONITORIMI I ZBATIMIT TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKË TË KAPITULLIT 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA	19
• Aktorët e përfshirë dhe rëndësia	21
• Draft Struktura e Raportit të Monitorimit të Strategjisë Sektoriale	23

---

## HYRJE

Udhërrëfytyesi për monitorimin e procesit dhe progresit të reformave dhe politikëbërjes së vendit për Kapitullin 24: Drejtësia, Liria e Siguria, në kuadër të procesit të integritit dhe negociatave me BE është i lidhur me GrupKapitullin 1 Themeloret. Ky udhërrëfytyes synon të ofrojë udhëzime dhe orientim praktik se si të monitorohet tërësia e reformave që po realizohen në Kapitullin 24: Drejtësia, Liria e Siguria në kuadër të bisedimeve për anëtarësim në BE për politikat që lidhen me çështjet e drejtësisë, lirisë e sigurisë.

Aspektet e politikave e zbatimit të tyre që lidhen me Kapitullin 24: Drejtësia, Liria e Siguria, bëjnë pjesë në të ashtuquajturat "Kriteret e Kopenhagenit", përcaktuar nga Këshilli Europian apo Samiti i Kopenhagenit mbajtur në 21-22 qershor 1993[1] gjatë presidencës daneze të BE. Në bazë të tyre, vendet anëtare të BE përcaktuan që çdo vend kandidat nga Europa Qendrore e Lindore duhet të plotësonte një sërë kriteresh të tillë: - Kriteri Politik: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve; - Kriteri Ekonomik: një ekonomi tregu funksionale, si dhe aftësinë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut që veprojnë brenda Bashkimit Europian; - Kriteri i Acquis: aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në mënyrë të veçantë objektivat politike, ekonomike dhe të bashkimit monetar. Ndërkohëgrupit të Kriereve të Kopenhagenit në vitin 1995 iu shtua edhe një kriter i katërt që u bë njohur si Kriteri i Madridit që u miratua nga Këshilli Europian apo Samit i Madridit, mbajtur më 15-16 dhjetor të 1995[2] në Madrid të Spanjës gjatë presidencës spanjolle të BE. Në bazë të këtij kriteri kërkohet që vendi kandidat të ketë kapacitetet e duhura administrative e gjyqësore që të zbatojë rregullat dhe procedurat e BE. Rëndësia e krijimit të strukturave të duhura në nivel administrativ dhe gjyqësor për rrjedhje është një parakusht për zbatimin efektiv të legjislacionit të BE.

Udhërrëfytyesi do të shërbejë si një mjet analize e monitorimi për organizatat e shoqërisë civile, ekspertët e integritit europian, studiuesit dhe përfaqësuesit e medias lidhur me vlerësimin nga ana e tyre të proceseve që kanë të bëjnë me integritimin europian të tilla si:

- 1) Shqyrtimi dhe përafrimi i legjislacionit të BE (Acquis i BE) me legjislacionin vendas për Kapitullin 24
- 2) Miratimi dhe zbatimi i reformave thelbësore në fushat e lidhura me Kapitullin 24
- 3) Progresi në përmbushjen e kriereve të përcaktuara nga institucionet kombëtare dhe BE –duke analizuar boshllëqet dhe sfidat kryesore në kuadrin ligjor dhe institucional
- 4) Përfshirja e Organizatave të Shoqërisë Civile dhe aktorëve të tjerë në procesin e negociatave për anëtarësim në BE dhe funksionimin e strukturave negociuese

---

[1] Samiti Europian i Kopenhagenit 21-22 Qershor 1993, Kopenhagen, Danimarkë, European Council in Copenhagen 21-22 June 1993 Conclusions of the Presidency , Link [Strategy Document: A Comprehensive Guide for Businesses https://stratagora.com/str](https://stratagora.com/strategy-document-a-comprehensive-guide-for-businesses)

[2] Samiti Europian i Madridit 15-16 Dhjetor 1995, Madrid, Spanjë, European Council in Madrid 15-16 December 1995 Conclusions of the Presidency , Link [Strategy Document: A Comprehensive Guide for Businesses https://stratagora.com/str](https://stratagora.com/strategy-document-a-comprehensive-guide-for-businesses)

Pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare (IGC) për negociatat e anëtarësimit të BE me Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut që u zhvillua më 19 korrik 2022 [3], nga ana e Komisionit European nisi procesi i vlerësimit dhe shqyrtimit (procesi Screening) të përputhueshmërisë së legjislacionit aktual shqiptar me atë të BE për të gjashtë grupkapitujt që kanë tashmë në përbërje 33 kapitujt e acquis, në bazë të përcaktimit të Metodologjisë së Zgjerimit të 5 Shkurtit 2020 [4] të Bashkimit European.

Pas realizimit të këtij procesi që përfundoi më 24 nëntor 2023, Shqipëria paraqiti ëpërveç Udhërrëfyesit për Administratën Publike [5] dhe Funksonimin e Institucioneve Demokratike [6] edhe një udhërrëfyes që lidhet veçanërisht me Kapitullin 24 siç është Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës [7], ku përcaktohet qëllimi dhe objektivat strategjike. Nëpërmjet VKM Nr. 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës [8] qeveria shqiptare ka hartuar një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike duke marrë në konsideratë vlerësimet dhe gjetjet e Komisionit European në të cilat gjenden një pjesë e politikave sektoriale që lidhen me Kapitullin 24: Drejtësia, Liria e Siguria.

Në këtë kuadër u shpreh angazhimi i qeverisë shqiptare dhe Komisionit European për ti përmbyllur negociatat për anëtarësim brenda 31 Dhjetorit 2027 duke synuar që brenda 2030 Shqipëria të jetë anëtar me të drejta të plota të Bashkimit European.

Shqipëria është angazhuar në mënyrë aktive në zbatimin e Planit të ri të Rritjes Ekonomike të BE për Ballkanin Perëndimor [9] i në katër shtyllat që lidhen me 1)integrimin gradual me tregun e vetëm të BE, 2)integrimin rajonal ekonomik, 3) reformat themelore dhe 4) rritja e mbështetjes financiare.

[3] Konferenca e Parë Ndërqeveritare mes Shqipërisë e BE për negociatat e anëtarësimit me BE, 19 Korrik 2022 , 19 July 2022 Link <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2022/07/19/intergovernmental-conference-at-ministerial-level-on-the-accession-of-albania/>

[4] Metodologjia e re e Zgjerimit e Bashkimit European, 5 Shkurt 2020, Link [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/api/files/document/print/el/statement\\_20\\_208/STATEMENT\\_20\\_208\\_EN.pdf](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/api/files/document/print/el/statement_20_208/STATEMENT_20_208_EN.pdf)

[5]VKM Nr 737 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030 (Fletore Zyrtare Nr 184,Viti 2023, Faqe 22098)

Link <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1>

[6]VKM Nr 611 datë 02.10.2024 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksonimin e Institucioneve Demokratike(FletoreNr168,Viti2024, Faqe19736)Link <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/168/9f6b14dc-c246-4860-b456-2812037b161e>

[7] VKM Nr 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës(Fletore Zyrtare Nr 184,Viti 2023, Faqe 22064)Link <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1>

[8] VKM Nr 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës(Fletore Zyrtare Nr 184,Viti 2023, Faqe 22064).

Link <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1>

[9] Rregullorja e Parlamentit European dhe Këshillit të Ministrave të BE e 14 Majit 2024 Mbi krijimin e Instrumentit për Reforma e Rritje Ekonomike të Ballkanit Perëndimor Link [https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2024/1449/oj/eng\\_](https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2024/1449/oj/eng_)

Axhenda e Reformave që Shqipëria [10] ka paraqitur në BE për të përfituar përfshin reforma në fusha të tilla si: (i) mjedisi i biznesit; (ii) kapitali njerëzor; (iii) dixhitalizimi; (iv) energjia dhe tranzicioni i gjelbër; dhe (v) të drejtat themelore dhe sundimi i ligjit.

## KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

Politikat e BE në këtë kapitull synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin European si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Kapitulli 24 përfshin fusha të tilla si kontrolli kufitar, vizat, migracioni, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar, drogës e terrorizmit, si edhe bashkëpunimi doganor apo ai gjyqësor në çështjet penale e civile. Zbatimi i legjislacionit të BE në këto fusha kërkon kapacitete administrative të qëndrueshme dhe mirëintegruara brenda agjencive zbatimit të ligjit dhe organet e tjera përkatëse, të cilat duhet të arrijnë standardet e nevojshme. Në mënyrë të ëveçantë organizimi profesional, i besueshëm dhe efikas i policisë ka rëndësi parësore në këtë drejtim. Këta elementë janë të rëndësishëm për garantimin e asaj që njihet si Hapësira e Përbashkët Europiane e Lirisë, Sigurisë e Drejtësisë (AFSJ- Area of Freedom, Security and Justice) siç e përcakton Neni 3(2) i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE).[11]

Pjesa më e detajuar e politikave të BE që përfshihet në Kapituillin 24 është acquis i Shengen-it, i cili nënkupton heqjen e kontroleve të brendshme të kufijve në BE.

Nëpërmjet VKM Nr 736 datë 13.12.2023 qeveria shqiptare ka hartuar gjithashtu një nga dokumentet më të rëndësishme strategjike duke marrë në konsideratë vlerësimet dhe gjetjet në Kapitullin 24: Drejtësia, Liria e Siguria .

Tab 1. Struktura e nënkapitujve sektorialë të Kapitullit 24: Drejtësia, Liria, Siguria

Nr.	Politikat sektoriale: Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria, Siguria
1	Lufta kundër krimit të organizuar
2	Lufta kundër terrorizmit

[11] EU:An area of freedom, security and justice- General aspects [Link https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/150/an-area-of-freedom-security-and-justice-general-aspects](https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/150/an-area-of-freedom-security-and-justice-general-aspects)

3	Bashkëpunimi në luftën kundër drogës
4	Migrimi i ligjshëm dhe i parregullt
5	Azili
6	Shengeni dhe kufijtë e jashtëm të BE
7	Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile e penale

Pas hapjes së negociatave për Grupin Kapitullin 1 Themeloret më 15 tetor 2024, nga ana e Komisionit Europian janë vendosur disa Piketa të Ndërmjetme (Interim Benchmarks) që duhen të përmbushen për këtë kapitull. Në këtë kuadër është e rëndësishme të vlerësohen këta elementë që në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në Pozicionin e Përbashkët Negociues të Bashkimit Europian në lidhje me Kapitullin 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria në kuadërtë negociatave për anëtarësim të Shqipërisë me BE për Grupin Kapitullin 1: Themeloret.

Në mënyrë që ti përgjigjet realizimit të këtyre Piketave të Ndërmjetme (Interim Benchmarks), Shqipëria ka hartuar dhe përditëson vazhdimisht kuadrin strategjik në nivel kombëtar përmes hartimit dhe miratimit të strategjive sektoriale që ndikojnë në luftën ndaj krimit të organizuar në përputhje me dokumentet politike e objektivat strategjike të BE ( të ashtuquajturat *acquis* e butë – *soft acquis*). Monitorimi i vazhdueshëm i Planit të Veprimit të këtyre strategjive dhe përditësimi i tyre në përputhje me afatet kohore ka rëndësi të veçantë për procesin negociues që lidhet me Kapitullin 24, për shkak të peshës e rëndësisë së tij.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin me sukses të negociatave për Kapitullin 24: Drejtësi, Liria, Siguria ka koordinimi ndër-institucional që realizohet përmes Grupit Ndër-institucional të Punës për Integrimin Europian (GNPIE). Për këtë kapitull bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimtarinë e tyre ligjore, institucionale 19 struktura të ndryshme që i përkasin qeverisë, agjencive dhe institucioneve të pavarura që raportojnë para Kuvendit të RSH.

Tab 2. Përbërja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Europian (GNPIE)  
 Kapitulli 24: Drejtësia, Lira, Siguria

Nr	Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Europian (GNPIE) Kapitulli 24: Drejtësia, Lira e Siguria
1	Ministria e Brendshme (MB) - Institucioni përgjegjës
2	Ministria e Drejtësisë (MD)
3	Ministria për Europën e Punët e Jashtme (MEPJ)
4	Ministria e Mbrojtjes (MM)
5	Ministria e Shëndetësisë e Mirëqënies Sociale (MSHMS)
6	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
7	Ministria e Financave (MF)
8	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)
9	Drejtoria e Azilit e Shtetësisë- DPPSH
10	Drejtoria e Antitrafikut & Migracionit- DPPSH
11	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit e Pastrimit të Parave (DPPP)
12	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)
13	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave e Tatimeve (DPTT)

14	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuessit (QKPA)
15	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKED)
16	Koordinatori Kombëtar për Luftën ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (KKLED)
17	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara (AAPSAK)
18	Instituti i Statistikave (INSTAT)
19	Autoriteti i Mediave Audiovizuale (AMA)

**\*\*Burimi: Urdhri i Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05.2019 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Europian"**

Me hapjen e negociatave, Ministria e Brendshme në cilësinë e institucionit përgjegjës të GNPIE që lidhet me Kapitullin 24 po punon dhe koordinon punën për realizimin e Piketave të Ndërmjetme, që përkthehen në një listë aktiviteteve që i nënshtrohen monitorimit të detajuar dhe ndikojnë në dinamikën e integritimit Europian në lidhje me këtë kapitull.

Niveli i parë i monitorimit i referohet realizimit të aktiviteteve individuale, niveli i dytë i referohet realizimit të aktiviteteve sipas nënkapitujve të Kapitullit 24, dhe niveli i tretë i monitorimit i referohet realizimit të përgjithshëm të aktiviteteve sipas Planit të Veprimit, ku GrupiNegociator raporton te Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian (PPIE), Ministria e Brendshme në cilësinë e institucionit drejtues për këtë kapitull ka institucionalizuar ngritjen e Tryezës së Diskutimit dhe Konsultimit, me anëtarësi rreth 30 përfaqësues nga shoqëria civile, universitete, media, profesionistë dhe ekspertë të ligjit, organizata ndërkombëtare etj. Me përfshirjen në këtë Platformë, mund të realizohet me lehtësi procesi i monitorimit dhe vlerësimit të procesit të hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave.

## MONITORIMI I NËNKAPITUJVE TË KAPITULLIT 24

### LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Shqipëria e ka fuqizuar luftën kundër krimit të organizuar përmes fuqizimit të kuadrit ligjor veçanërisht me rritjen e kapaciteteve institucionale ku përfshihet krijimi i Prokurorisë e Gjykatës së Juridiksionit të Posaçëm siç është Struktura e Posaçme Antikorrupcion e Kundër Krimit të Organizuar (SPAK). Kjo strukturë që prej vitit 2021 kur filloi nga funksionimi, ka realizuar një sërë hetimesh që kanë bërë të mundur goditjen e sekuestrimit e aseteve të krijuara nga aktivitetet e lidhura me krimin e organizuar, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me trafikun e drogave të forta.

Treguesit e monitorimit në fushën e “Luftës kundër krimit të organizuar” mund të përfshijnë nivelin e realizimit të aktiviteteve që lidhen me përmbushjen e detyrimeve që përbëjnë Piketat e Ndërmjetme.

- Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe institucionale për të luftuar krimin e organizuar, në mënyrë që të përputhet plotësisht me acquis e BE, e cila përfshin legjislacionin në lidhje me kriminalizimin e pastrimit të parave, si dhe evidentimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale.
- Forcimi i mëtejshëm i përpjekjeve për bashkëpunim për zbatimin e ligjit me Shtetet Anëtare të BE dhe strukturat si CEPOL, EUROPOL dhe EUROJUST e EMPACT (form Against Criminal Threats),
- Përpjekje për të konsoliduar historikun e hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve përfundimtare dhe sekuestrimit e konfiskimit të aseteve që lidhen me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, përmes bashkëpunimit ndërkombëtar proaktiv dhe efektiv duke u ofruar institucioneve që luftojnë krimin e organizuar burime të mjaftueshme.
- Procedurat e hetimit penal të shoqërohen sistematikisht nga hetimet financiare që nga fillimi duke zhvilluar kapacitete institucionale për të realizuar hetimet komplekse në fushën e krimeve financiare.
- Angazhim i mëtejshëm i Shqipërisë për të rritur sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, për të ngrirë asetet që lidhen me aktivitetet kriminale dhe për të promovuar ripërdorimin e tyre për qëllime sociale. BE vëren se Shqipëria është hequr nga lista e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) e juridiksioneve nën monitorim të shtuar pas pezullimit të amnistisë fiskale të planifikuar.
- Realizimin e ndryshimeve të ardhshme ligjore në Kodin Penal duke garantuar që amnistitë e mundshme fiskale të jenë në përputhje me objektivat strategjike të vendit, të nxisin luftën kundër krimit të organizuar dhe të jenë në përputhje me acquis përkatëse të BE dhe standardet ndërkombëtare, të tilla si ato të përcaktuara nga Moneyval të Këshillit të Europës dhe FATF.

- Miratimi i të gjithë legjislacionit dhe masat e nevojshme në fushën e krimit kibernetik duke përfshirë aderimin e RSH në Protokollin e Dytë Shtesë të Konventës së Budapestit për të luftuar në mënyrë efektive krimin kibernetik. Shqipëria duhet të krijojë një histori të qëndrueshme në lidhje me parandalimin dhe goditjen e krimit kibernetik, veçanërisht përmes një përgjigjeje më efektive në zbatimin e ligjit, duke u përqendruar në zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të kriminelëve kibernetikë.
- Klasifikimi si vepra penale të të gjitha formave të abuzimit seksual të fëmijëve duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe parandalimit (përfshirë parandalimin e riviktimizimit) të abuzimit seksual të fëmijëve në internet (online) dhe jashtë internetit (offline).
- Zvogëlimi i pranisë dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit duke përshtatur masatme qëllimet e Udhërrëfyesit Rajonal për të Kontrolluar më mirë Armët e Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor.
- Ndërgjegjësim dhe edukim mbi rreziqet që lidhen me keqpërdorimin, posedimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit, çka bën të mundur zvogëlimin ezotërimin të paligjshëm të armëve të zjarrit përmes legalizimit, dorëzimit vullnetar dhe çaktivizimit
- Forcimi i masave kundër trafikimit me fokus në ndikimin e rëndësishëm tek gratë dhe vajzat duke qenë se Shqipëria është një vend origjine, tranziti dhe destinacioni i trafikimit të qenieve njerëzore.
- Përmirësimi i mekanizmave për identifikimin e hershëm dhe mbrojtjen e viktimave përmes një qasjeje të përqendruar te viktima, e cila duhet të jetë më e mirë dhe më e vazhdueshme e integruar në hetime dhe ndjekje penale.
- BE nënvizon se Shqipëria duhet të zhvillojë një historik të qëndrueshëm të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në këtë fushë.

Tab 14: Kuadri strategjik sektorial për Luftën ndaj Krimit të Organizuar

Nr	Kuadri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20oscreening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20oscreening%20report_external%20version.pdf</a>
2	VKM Nr 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e Së Drejtës 2023-2030 (Fletore Zyrtare Nr 184, Viti 2023, Faqe 22064)	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1">https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1</a>

3	VKM Nr 1139 datë 24.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 (Fletore Zyrtare Nr 4, Viti 2021, Faqe 618)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139</a>
4	VKM Nr.1140, datë 24.12.2020 Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022 (Fletore Zyrtare Nr 4, Viti 2021, Faqe 664)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1140">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1140</a>
5	VKM Nr. 458, datë 10.7.2024 PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA, 2021-2025, DHE PLANIN E VEPRIMIT 2023-2025", TË NDRYSHUAR	<a href="https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2025/05/Miratimi-i-Strategjise-kunder-Krimit-te-Organizuar-dhe-Krimeve-te-Renda-2021-2025-dhe-Planin-e-Veprimit-2023-2025_VKM.pdf">https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2025/05/Miratimi-i-Strategjise-kunder-Krimit-te-Organizuar-dhe-Krimeve-te-Renda-2021-2025-dhe-Planin-e-Veprimit-2023-2025_VKM.pdf</a>

Një nga dokumentet strategjike më të rëndësishëm që i përket këtij nënkapitulli është VKM Nr.1140, datë 24.12.2020 Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022. Në këtë strategji përcaktohen objektivat lidhur me masat ligjore e institucionale ashtu sikurse dhe roli e përgjegjësia e institucioneve si Ministria e Brendshme (MB), Ministria e Drejtësisë (MD), Prokuroria e Përgjithshme, SPAK , Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) në realizimin e këtyre objektivave strategjike.

## V.2 LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT

Përsa i përket luftës kundër terrorizmit Shqipëria e ka fuqizuar luftën kundër saj në mënyrë të qëndrueshme që pas gjysmës së dytë të viteve '90 e veçanërisht pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 duke rritur fuqizuar kapacitetet institucionale dhe përafuar kuadrin ligjor me konventat ndërkombëtare në këtë fushë të Acquis së BE. Tashmë veprat penale që lidhen me terrorizmin hetohen e gjykohen nga Prokuroria dhe Gjykata e Juridiksionit të Posaçëm sic është Struktura e Posacme Antikorrupcion e Kundër Krimit të Organizuar (SPAK). Kjo strukturë që prej vitit 2021 kur filloi nga funksionimi, ka realizuar një sërë hetimesh që kanë bërë të mundur goditjen e aktiviteteve të lidhura me terrorizmin e shfaqjen e radikalizimit të dhunshëm offline dhe online .

Treguesit për monitorimin në fushën e “Luftës kundër terrorizmit” do të përfshijnë nivelin e realizimit të aktiviteteve që lidhen me përmbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Ndryshimi i kuadrit strategjik, ligjor dhe institucional për të luftuar terrorizmin, në mënyrë që të jetë plotësisht në përputhje me acquis e BE.
- Bashkëpunimi mes agjencive të ndryshme në nivel kombëtar e për të forcuar mekanizmat e menaxhimit dhe referimit të rasteve të terrorizmit.
- Forcimi i përpjekjeve për parandalimin e radikalizimit në burgje dhe përhapjen e përmbajtjes terroriste në internet.
- Adresimi i financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave në veçanti duke përmirësuar efektivitetin e hetimeve të financimit të terrorizmit.
- Ndryshimin e legjislacionit që rregullon përdorimin e Regjistrit të Emrit të Pasagjerëve (PNR) në mënyrë që të rritet aftësia e institucioneve ligjzbatuese shqiptare për të luftuar terrorizmin dhe veprat penale serioze që kanë lidhje me udhëtimin ajror.
- Angazhimi i Shqipërisë për të mbrojtur infrastrukturën e saj kritike përmes rishikimit të kuadrit të saj ligjor mbi qëndrueshmërinë e kësaj infrastrukturë që mund të jenë subjekt i sulmeve terroriste të formave hibride (terrorizmi kibernetik dhe ai fizik)
- Përmirësimi e fuqizimi i kapaciteteve institucionale për identifikimin e vlerësimin e infrastrukturës kritike duke hartuar kritere për menaxhimin e tyre, përfshirë analizën e riskut.
- Vendosjen e sigurt të rrjeteve 5G së bashku me zbatimin gjithëpërfshirës të mjeteve të BE për sigurinë kibernetike 5G.

Nr	Kuadri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf</a>
2	VKM Nr 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e Së Drejtës 2023-2030 (Fletore Zyrtare Nr 184, Viti 2023, Faqe 22064)	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1">https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1</a>
3	VKM Nr 1137 datë 16.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2023 (Fletore Zyrtare Nr 5, Viti 2021, Faqe 859)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1137">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1137</a>

## V.3 BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR DROGËS

Lufta kundër trafikut të drogës është një nga elementët më të rëndësishëm që përfshihet tek nënkapitujt e Kapitullit 24. Aspektet e luftës ndaj trafikut të lëndëve narkotike janë të ndërlidhura ngushtë me atë të pastrimit të parave dhe elementë të tjerë të rëndësishëm të garantimit të asaj që njihet si Hapësira e Përbashkët Europiane e Lirisë, Sigurisë e Drejtësisë sic e përcakton Neni 3(2) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (TFEU).

Treguesit e monitorimit për fushën e “Luftës kundër drogës” do të përfshijnë nivelin e realizimit të aktiviteteve që lidhen me përmbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Miratimi i një kornize strategjike gjithëpërfshirëse në fushën e luftës kundër drogës.
- Shqipëria duhet të tregojë një qasje strategjike gjithëpërfshirëse për të luftuar në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme kultivimin, prodhimin dhe trafikimin e drogës.
- Krijimi i një Observatori Kombëtar për Drogën dhe një Sistemi Kombëtar Operativ të Paralajmërimit të Hershëm mbi shkëmbimin e informacionit në lidhje me substancat e reja psikoaktive.
- Regjistër i plotë me të dhëna lidhur me rastet që dëshmojnë një historik të qëndrueshëm nga ana e autoriteteve shqiptare lidhur me sekuestrimin dhe shkatërrimin e sasive të drogës që kapet në operacionet policore si dhe të konfiskimit të aseteve përkatëse që burojnë nga trafiku i lëndëve narkotike.

Nr	Kuadri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf</a>
2	VKM Nr 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e Së Drejtës 2023-2030 (Fletore Zyrtare Nr 184, Viti 2023, Faqe 22064)	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1">https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1</a>
3	Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet, 2021-2026, dhe të planit të veprimit 2021-2023	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139</a>

## V.4 MIGRACIONI I RREGULLT DHE I PARREGULLT

Ligji Nr 79/2021 datë 24.06.2021 Për të Huajt[12] është kuadri ligjor bazë për trajtimin e të huajve në Shqipëri. Nga ana tjetër ka rëndësi monitorimi i mënyrës së trajtimit të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht të miturit e pashoqëruar, si dhe procedurat për ofrimin e ndihmës në tranzit, procedurat e kthimit.

Korniza kryesore strategjike për politikën e migracionit në Shqipëri është Strategjia Kombëtare e Migracionit (SKM)[13] dhe strategji të tjera sektoriale që lidhen me faktorët shtytës të migracionit, siç janë arsimi, punësimi, zhvillimi ekonomik dhe social, etj. Strategjia Kombëtare e Migracionit (SKM) dhe Plani i Veprimit 2024–2030 [14] është dokumenti kryesor politik në fushën e migracionit, i cili udhëheq punën e institucioneve të përfshira.

Një nga shtyllat kryesore të këtij dokumenti është zhvillimi i politikave efektive për menaxhimin e migracionit brenda vendit, që përfshin sigurimin e të drejtës së çdo personi për mbrojtje të barabartë para ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Nga ana tjetër, një numër strategjish sektoriale që janë aktualisht në fuqi kanë përfshirë çështjet e migracionit brenda objektivave të tyre strategjike dhe planeve të veprimit, siç janë; Strategjia Kundër Krimin të Organizuar dhe të Rëndë 2021–2025; Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë e Komunitetit 2021–2026; Strategjia Ndërsektoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufijve 2021–2027; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe Plani i Veprimit.

Përveç kësaj, është i rëndësishëm vlerësimi i akteve nënligjore që garantojnë migrimin e ligjshëm të shtetasve të huaj në Shqipëri dhe përpuethshmëria e tyre me Acquis e BE me bazë Ligjin Nr 79/2021 datë 24.06.2021 Për të Huajt [15]. Vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të tyre nënkupton sesi ato rregullojnë bashkëpunimin e strukturave përkatëse për migracionin ose sesi kanë përcaktuar dispozita rregullatore, në lidhje me procedurën për zgjatjen e periudhës së qëndrimit, regjistrimin e të huajit pranë autoritetit vendor përgjegjës për kufirin dhe migracionin, miratimin e lejes së tyre të qëndrimit, si dhe format e dokumenteve të ndryshme për të huajt, në rast të humbjes ose dëmtimit të tyre.

Nga ana tjetër ka rëndësi monitorimi i mënyrës së trajtimit të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë, veçanërisht të miturit e pashoqëruar, si dhe procedurat për ofrimin e ndihmës në tranzit, procedurat e kthimit ose organizimin e operacioneve të përbashkëta të kthimit nga ajri.

[12] <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/79/a2ff0be0-d4a8-4089-94c4-3a7ba1846a9b>

[13] VKM Nr 271 datë 02.05.2024 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të saj të Veprimit 2024–2026 (Fletore Zyrtare Nr 46, Viti 2005 Faqe 2343) Link: [EU: An area of freedom, security and justice- General aspects](https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/150/an-area-of-freedom-security-and-justice-general-aspects) Link <https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/150/an-area-of-freedom-security-and-justice-general-aspects>

[4] ibid

[15] Ligji Nr 79/2021 datë 24.06.2021 Për të Huajt (Fletore Zyrtare Nr 162, Viti 2021, Faqe 14969)

Link: <https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/79/a2ff0be0-d4a8-4089-94c4-3a7ba1846a9b?q=profili%20i%20zgjeruar>

Nr	Kuatri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf</a>
2	Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026	<a href="https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/271">https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/271</a>
3	Ligji Nr 79/2021 datë 24.06.2021 Për të Huajt	<a href="https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/LIGJ-PER-TE-HUAJT-Nr.-792021.pdf">https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/LIGJ-PER-TE-HUAJT-Nr.-792021.pdf</a>
4	Ligji Nr. 10 2021, datë 01.02.2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë"	<a href="https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Ligji-per-Azilin-ne-RSH_nr.-10.2021.pdf">https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Ligji-per-Azilin-ne-RSH_nr.-10.2021.pdf</a>

Treguesit e monitorimit për fushën “Migracioni i rregullt e i parregullt” do të përfshijnë nivelin e realizimit të masave që lidhen me përbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit dhe Planin e Veprimit të BE për Ballkanin Perëndimor, të Komisionit Europian.
- Hartimi, miratimi, testimi dhe financimi i Planeve të Emergjencës në rast të një numri të konsiderueshëm mbërritjesh të migrantëve dhe azilkërkuesve.
- Miratimi i ndryshimeve të nevojshme në legjislacionin kombëtar lidhur me fushën e migracionit të ligjshëm për t'u përafuar me disa dispozita mbi bashkimin familjar, me lejen e vetme dhe me ndryshimet e fundit mbi Kartën Blu të BE.
- Realizimi i ndryshimeve ligjore lidhur me fushën e migracionit të parregullt, për t'u përafuar me Direktivën e BE të Sanksioneve për Punëdhënësit/ Directive 2009/52/EC.
- Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.
- Garantimi i kapaciteteve të përshtatshme të pritjes dhe zbatimi i procedurave të kthimit në përputhje me Ligjin për të Huajt dhe Acquis e BE

## V.5 AZILI

Monitorimi i kuadrit ligjor e institucional lidhur dhe me kapacitetet administrative për menaxhimin e procedurave të azilit e mbrojtjes ndërkombëtare në Shqipëri është me rëndësi si pjesë e një nënkapitulli brenda Kapitullit 24. Kuadri ligjor bazë mbetet Ligji Nr. 10 2021, datë 01.02.2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” [16], një akt ligjor i përafuar me Sistemin e Përbashkët Europian të Azilit ose konventat ndërkombëtare, i cili në dispozitat e tij parashikon të drejtën e azilit si një e drejtë themelore për të gjithë shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që ndodhen jashtë territorit të vendbanimit të tyre, dhe për arsye objektive kërkojnë mbrojtje. Elementet e monitorimit që lidhen me zbatimin e legjislacionit e përmbushjen e standardeve të BE përsa i përket procedurave të dhënies së azilit apo mbrojtjes së përkohshme për individë të ndryshëm përfshijnë respektimin e kushteve për dhënien e formave të ndryshme të mbrojtjes për azilkërkuesit, duke përfshirë statusin e refugjatit, mbrojtjen plotësuese dhe atë të përkohshme.

Nr	Kuadri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf</a>
2	Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit	<a href="https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/1271">https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/1271</a>
3	Ligji Nr. 10 2021, datë 01.02.2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”	<a href="https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Ligji-per-Azilin-ne-RSH_nr.-10.2021.pdf">https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Ligji-per-Azilin-ne-RSH_nr.-10.2021.pdf</a>

[16] Ligji Nr 10/2021 datë 01.02.2021 Për Azilin ( Fletore Zyrtare Nr 28, Viti 2021, Faqe 3720)

Link:<https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2021/02/01/10/48ad6f04-07d2-4d94-ad90-3df7051c6e84?q=Azili>

Treguesit e monitorimit në fushën e “Azilit” do të përfshijnë nivelin e realizimit të masave që lidhen me përmbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Zbatim cilësor i Ligjit Nr. 10/2021 për Azilin dhe kapacitetet e nevojshme shtesë administrative, duke siguruar njëkohësisht përafrim të mëtëjshëm me acquis e BE.

---

## V.5 POLITIKA E VIZAVE, SHENGEN DHE KUFIJTË E JASHTËM TË BE

Një tjetër nënkaptull i Kapitullit 24 është i lidhur ngushtësisht me përafrimin e legjislacionit kombëtar me Acquis e BE sa i përket lëvizjes në zonën Shengen dhe sigurinë e menaxhimit e integruar të kufirit. Korniza ligjore në fushën e Politikës së Vizave të Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me acquis e BE dhe ligji kuadër është Ligji Nr. 79/2021 datë 24.06.2021 “Për të Huajt” [17]. Nga pikëpamja institucionale janë Misionet Diplommatike dhe Konsullore të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) si autoriteti përgjegjës për pranimin dhe lëshimin e vizave. Procesi i aplikimit dhe verifikimit për të huajt që marrin vizë për të vizituar Shqipërinë është i ngjashëm me atë të parashikuar në acquis e BE. Nga ana tjetër, Shqipëria ka Marrëveshje për Lëvizjen Pa Viza gjatë gjithë vitit me tetë vende, të cilat nuk mund të udhëtojnë pa vizë në BE, të tilla si: Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kina, Guajana, Kazakistani, Kuvajti dhe Turqia. Kjo është një çështje që BE e ka përcaktuar se nuk është në përputhje me politikën e saj.

Monitorimi duhet të përfshijë politikën e vizave lidhur me përafrimin e saj me Rregulloren (BE) 2018/1806 të 14 nëntorit 2018, e cila ka të bëjë me listën e vendeve të treta, shtetasit e të cilave duhet të jenë të pajisur me viza kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe listën e vendeve, shtetasit e të cilave janë të përjashtuar nga kjo kërkesë. Shqipëria është e angazhuar për të përafruar më tej politikën e saj të vizave me listën e vendeve të BE, veçanërisht në lidhje me vendet që paraqesin rreziqe për migrim të parregullt ose siguri për BE.

Një nga elementët e monitorimit duhet të përfshijë raportimin e Shqipërisë si pjesë e Formatit të Raportimit të Mekanizmit të Pezullimit të Liberalizimit të Vizave të BE dhe sesi Shqipëria zbaton e realizon fushatat informuese për shtetasit e saj në lidhje me regjimin e lëvizjes pa viza në BE.

---

[17] Ligji Nr 79/2021 datë 24.06.2021 Për të Huajt (Fletore Zyrtare Nr 162, Viti 2021, Faqe 14969)

Link:<https://www.qbz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/79/a2ff0be0-d4a8-4089-94c4-3a7ba1846a9b?q=profili%20i%20zgjeruar>

Nr	Kuadri Ligjor	Link
1	Raporti i Shqyrtimit për GrupKapitullin e I-rë - Themeloret (Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , 135 pages)	<a href="https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf">https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf</a>
2	Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit	<a href="https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/271">https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/05/02/271</a>
3	<u>Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021 – 2027</u> <u>Raport monitorimi për periudhën Janar – Qershor 2023</u>	<a href="https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/MIK_-_Raport-Monitorimi-Janar-Qershor-2023.docx">https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/MIK_-_Raport-Monitorimi-Janar-Qershor-2023.docx</a>

Treguesit e monitorimit në fushën “Politikat e Vizave, Shengeni e kufijtë e jashtëm të BE ” do të përfshijnë nivelin e realizimit të aktiveve që lidhen me përmbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Politika e vizave e Shqipërisë nuk është ende plotësisht në përputhje me atë të BE dhe heqja e përkohshme e kërkesave për viza nuk është në përputhje me acquis e BE.
- Përafrimi i politikës së vizave me BE dhe përshtatje shtesë teknike e sistemeve të informacionit të vizave të Shqipërisë për t'u përputhur me Sistemin e Informacionit për Vizat (VIS) të BE.

## V.7 BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJET PENALE E CIVILE

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile e veçanërisht në ato penale është një çështje me rëndësi për Bashkimin Europian, sidomos pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës (2009) apo Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE).

Nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian, lindi sidomos pas krijimit të tregut të përbashkët të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Traktati i Nicës parashikoi për herë të parë krijimin e Eurojust-it, si Njësia Europiane e Bashkëpunimit Gjyqësor, përgjegjëse për të mbështetur dhe forcuar bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale mes autoriteteve të hetimit dhe ndjekjes penale të Shteteve Anëtare. Traktati i Lisbonës solli risi të rëndësishme në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale si p.sh. zgjerimin e kompetencave të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian dhe përfshiu aktorë të rinj në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Po ashtu, dispozitat ligjore të parashikuara nga ky traktat lejojnë përafrimin si në aspektin procedural, po ashtu edhe në atë material të së drejtës penale. Psh Urdhri i Ndalimit është cilësuar si instrumenti më i rëndësishëm i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian. Bashkimi Europian e konsideron parimin e njohjes reciproke si gurin e themelit të bashkëpunimit gjyqësor, si në fushën civile, ashtu edhe në atë penale. Urdhri Europian i Ndalimit është një vendim aut parashikon një listë prserioze, të dënueshme me heqje lirie me të paktën tre vje aktKy instrument shfuqizoi ndërmjet Shteteve Anëtare, njëqë është ai i ekstradimit. Në rastin e Shqipërisë është e rëndësishme të monitorohet zbatimi i një sërë konventash që lidhen me bashkëpunimin në çështjet gjyqësore e penale veçanërisht ato me EUROPOL e EUROJUST.

Treguesit e monitorimit në fushën “Bashkëpunimi në çështjet penale e civile” do të përfshijnë nivelin e realizimit të aktiviteve që lidhen me përmbushjen e një sërë detyrimesh që përbëjnë ato që njihen si Piketat e Ndërmjetme:

- Përafrimi i mëtejshëm me *acquis* e BE të parimeve themelore të bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare të sanksionuara në legjislacionin e saj.
- Ratifikim i konventave ndërkombëtare që ende kanë mbetur pa u nënshkruar e ratifikuar nga Shqipëria në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, veçanërisht Konventën e Hagës për Marrëveshjet e Zgjedhjes së Gjykatës (2005).
- Fuqizimi i kapacitetit administrativ në nivel të pushtetit ekzekutiv e gjyqësor për të përmbushur kërkesat e BE mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare.

---

## V.7 MONITORIMI I ZBATIMIT TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE TË KAPITULLIT 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

Në kuadër të Kapitullit 24 : Drejtësia, Liria, Siguria janë miratuar nga qeveria shqiptare një sërë strategjish sektoriale në përmbudhje të plotësimin të objektivave strategjike apo piketave të ndërmjeme që ka përcaktuar Bashkimi Europian

---

Nr	Strategjia	Link
1	VKM Nr. 736 datë 13.12.2023 Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e Së Drejtës 2023-2030 (Fletore Zyrtare Nr 184, Viti 2023, Faqe 22064)	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1">https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1</a>
2	VKM Nr. 1137 datë 16.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2023(Fletore Zyrtare Nr 5, Viti 2021, Faqe 859)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1137">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1137</a>
3	VKM Nr. 1139 datë 24.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 (Fletore Zyrtare Nr 4, Viti 2021, Faqe 618)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1139</a>
4	VKM Nr.1140, datë 24.12.2020 Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022 (Fletore Zyrtare Nr 4, Viti 2021, Faqe 664)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1140">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/24/1140</a>
5	VKM Nr. 729 datë 13.12.2023 Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të Planit të saj të Veprimit dhe të pasaportës së treguesve (Fletore Zyrtare Nr 186, Viti 2023, Faqe 22201) Link	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/186/198e150f-ed3e-4938-846f-d6afb328dd0b">https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/186/198e150f-ed3e-4938-846f-d6afb328dd0b</a>
6	VKM Nr. 1117, datë 16.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 (Fletore Zyrtare Nr 7, Viti 2021, Faqe 1379)	<a href="http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1117">http://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/12/16/1117</a>
7	VKM Nr. 271 datë 02.05.2024 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të saj të Veprimit 2024-2026 (Fletore Zyrtare Nr. 46, Viti 2005 Faqe 2343)	<a href="https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2005/05/06/296/f3df3fb2-5388-4abd-8cf2-763f4510b876?q=Profilit%20t%C3%AB%20zgjeruar%20t%C3%AB%20migracionit%20">https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2005/05/06/296/f3df3fb2-5388-4abd-8cf2-763f4510b876?q=Profilit%20t%C3%AB%20zgjeruar%20t%C3%AB%20migracionit%20</a>

Është e rëndësishme që përveç zbatimit rigoroz institucionet përgjegjëse, të bëhet dhe një monitorim dhe raportim në kohë të ecurisë së zbatimit. Çdo udhërrëfyes monitorimi duhet të ketë gjithmonë parasysh Ministrinë përgjegjëse për zbatimin e strategjisë që është një faktor i rëndësishëm që do të lehtësojë gjatë procesit mbledhjen e të dhënave nga institucionet përgjegjëse.

---

## 2. AKTORËT E PËRFSHIRË DHE RËNDËSIA

Pavarësisht monitorimit nga institucioni përgjegjës, një monitorim realist dhe i pavarur është i rëndësishëm të bëhet edhe nga të tretët, si: organizata të shoqërisë civile, ekspertë të pavarur apo akademia. Një monitorim i tillë mund të bëhet për të vlerësuar punën e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë, por edhe për të verifikuar dhe nxjerrë të dhëna më të detajuara, për aspekte me rëndësi në punën e tyre: si për shembull matja e progresit lidhur me aspekte të caktuara të një sektori, apo për të vlerësuar avancimin e sektorit, kundrejt detyrimeve që burojnë në kuadër të integritit.

### 1. Monitorimi në bazë të afateve dhe mbështetur në të dhëna

Monitorimi duhet të bëhet për të marrë të dhëna të caktuara lidhur me një aspekt të politikës sektoriale, sesi janë plotësuar detyrimet që burojnë nga integrimi Europian për sektorin. E rëndësishme gjithashtu është të përcaktohen afatet brenda të cilave do të vlerësohet apo matet ecuria e progresit të zbatimit të objektivave të dokumentit strategjik. Psh. për 6 muajt e parë, apo për vitin e parë të dytë, të tretë, etj. të zbatimit të strategjisë.

### 2. Identifikimi i treguesve kryesorë të matjes së performancës të politikave apo objektivave të përzgjedhur

Një proces i rëndësishëm është përzgjedhja e treguesve kryesorë të performancës për çdo objektiv specifik të strategjisë, të cilat do të përdoren në matjen e progresit dhe përmbushjen e rezultateve të pritshme. Në varësi të qëllimit dhe interesit, mund të përdoren të gjithë treguesit që i përkasin një objektivi, të vendosur dhe përzgjedhur nga dokumenti strategjik, apo disa prej tyre.

Gjithashtu mund të identifikohen tregues shtesë, që matin progresin e objektivave apo masave të dokumentit, të cilët nuk janë të parashikuar në dokumentin strategjik. Në këtë rast duhet përkrahur metodologjia e matjes dhe sistemi i referimit që përdoret për vlerësimin e progresit.

### 3. Identifikimi i të dhënave të nevojshme dhe burimeve të tyre

Pas përzgjedhjes të treguesve mbi bazën e të cilëve do të kryhet vlerësimi, është e rëndësishme të identifikohen të dhënat apo informacionet që shërbejnë për matjen e tyre, sipas një formule. Identifikimi i saktë i të dhënave apo informacionit është i rëndësishëm në mënyrë që të kemi aplikimin e rregullt të formulës së matjes dhe marrjen e një rezultati të saktë.

---

Njëkohësisht me evidentimin e të dhënave të nevojshme, ka rëndësi identifikimi i institucioneve të ndryshme ku krijohen, mbahen apo përpunohen të dhënat. Burimi i të dhënave përveç institucioneve vendase apo dokumenteve të prodhuara prej tyre, mund të jenë edhe dokumentet e hartuara nga organizatat ndërkombëtare, të cilat mbledhin dhe përpunojnë të dhëna për sektorë të ndryshëm.

Në varësi të të dhënave të nevojshme, identifikohen edhe mjetet e mbledhjes së të dhënave, të cilat mund të përfshijnë kërkesa për informacion pranë institucioneve, konsultim të faqeve zyrtare në internet, apo dokumente publike, anketa, sondazhe, intervista, analizim dokumentesh, etj.

Pavarësisht burimit dhe mjetit të përdorur për të mbledhur të dhënat dhe informacionet e nevojshme për monitorim, është e rëndësishme që të mbahet në konsideratë, identifikimi i saktë i të dhënave dhe cilësia e tyre. Në çdo proces monitorimi të dokumenteve strategjike ka rëndësi që të dhënat të jenë të plota dhe ato mund të organizohen në formate që lehtësojnë analizimin dhe vlerësimin, siç mund të jetë në tabela ose grafikë.

#### 4. Analizimi i të dhënave të mbledhura dhe vlerësimi i ecurisë së zbatimit

Pasi sigurohen të dhënat, analiza e tyre dhe hartimi i raportit të monitorimit bëhet për secilin tregues matës, bazuar në metodologjinë dhe formulën e matjes, si dhe duke i krahasuar rezultatet e dala me vlerat bazë dhe vlerat e synuara të treguesit. Çdo rezultat si rrjedhojë shoqërohet me një analizë të arsyetuar, e cila shpjegon progresin dhe punën e bërë për realizimin e tij, si dhe, sipas rastit, evidenton shkaqet apo pengesat që kanë ndikuar në mospërbushjen e rezultateve.

Pas analizimit të treguesve përkatës, analizohet dhe vlerësohet shkalla e progresit për çdo qëllim politike, objektiv strategjik, duke përfshirë njëkohësisht edhe ndikimin e rezultatit në progresin e bërë në përbushjen e standardeve të BE apo përafrimin me *acquis*. Edhe në këtë rast evidentohen problemet e konstatuara gjatë zbatimit, si dhe shkaqet që kanë ndikuar në mosrealizimin në masën e synuar të objektivave apo qëllimeve të strategjisë.

#### 5. Hartimi i raportit të monitorimit dhe evidentimi i arritjeve apo mangësive

Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave Raport i Monitorimit të dokumentit strategjik përfaqëson një strukturë të qartë, e cila jep informacion të plotë dhe të kuptueshëm. Hartimi i një strukture të organizuar dhe një gjuhe tëthjeshtë ndihmon që të kuptohet ecuria e strategjisë nga publiku si dhe orienton administratën në marrjen e vendimeve për rishikimin dhe përmirësimin e strategjisë.

## Draft Struktura e Raportit të Monitorimit të Strategjisë Sektoriale

### 1. Përmbledhja Ekzekutive



Në këtë pjesë mund të përshkruhen:

- qëllimi dhe arsyeja e monitorimit të dokumentit strategjik, apo pjesëve të tij
- shkurtimisht përmbajtja e dokumentit strategjik, përfshirë qëllimet, objektivat dhe fushat kryesore ku orientohen masat dhe veprimet
- shkurtimisht rezultatet mbi progresin, sfidat dhe rekomandimet që dalin nga Monitorimi

### 2. Hyrje



Në këtë pjesë mund të jepet:

- përshkrimi i kontekstit dhe rëndësia e strategjisë që po monitorohet për sektorin apo sektorët që mbulon (p.sh., në lidhje me krimin e organizuar, migracionin, luftën kundër drogave.).
- sqarimi i qëllimeve të monitorimit (p.sh., vlerësimi i realizimit të objektivave, progresi në kuadër të integritimit, ofrimi i asistencës për përmirësim, progresi i piketave të ndërmjetme etj).
- burimet dhe mjetet që janë përdorur për të mbledhur dhe analizuar të dhënat (p.sh., intervista, anketa, analiza të të dhënave statistikore).

### 3. Përshkrimi i dokumentit strategjik dhe Planit të Veprimit



Në këtë pjesë mund të përshkruhen:

- qëllimet e politikave dhe objektivave specifike të strategjisë të marrë në monitorim
- masat dhe aktivitetet që janë planifikuar të realizohen për arritjen e këtyre objektivave
- rezultatet e synuara dhe burimet financiare të parashikuara për realizimin e strategjisë

## 4. Analizimi dhe vlerësimi i progresit të zbatimit



Kjo pjesë jep rezultatet e monitorimit, bazuar në matjen dhe vlerësimin e treguesve të

performancës. Ajo duhet të përmbajë:

- përcaktimin e aktivitete të realizuara dhe ato në proces,
- ilustrimin e progresit nëpërmjet të dhënave që rezultojnë nga treguesit e matshëm
- analizën e arsyeve të progresit apo mospërmbushjes në realizimin e masave, duke evidentuar faktorët që kanë ndikuar (si buxheti në dispozicion, koha, kapacitetet institucionale, etj.)
- analizën dhe vlerësimin mbi shkallën e progresit së objektivave dhe qëllimeve të strategjisë dhe sesa janë përmbushur prioritetet e sektorit.

## 5. Evidentimi i problemeve dhe sfidave për të ardhmen



Kjo pjesë mund të përmbajë:

- problemet e evidentuara gjatë zbatimit
- pengesave që kanë ndikuar në mosrealizimin në masën e synuar të objektivave të strategjisë
- shkallën e përfshirjes së institucioneve përgjegjëse apo kontribuese, shoqërisë civile, grupeve të interesit apo qytetarët në procesin e zbatimit dhe monitorimit.

## 6. Rekomandime



Në këtë pjesë jepen sugjerime:

- për rishikimin e planit të veprimit, duke përfshirë rishikimin e masave apo aktiviteteve,
- rishpërndarjen e burimeve, ngritjen e kapaciteteve institucionale, etj.
- për zgjidhjen e problematikave, duke adresuar shkaqet e tyre
- për përmirësim në procesin e raportimit apo metodologjinë e monitorimit

## 7. Përfundime

---



Kjo pjesë bën një përmbledhje të gjetjeve kryesore të monitorimit, duke përfshirë arritjet, problematikat, si dhe sugjerimet për përmirësim.

## 8. Konsultimi i raportit të monitorimit

---



Është e rëndësishme që raporti i monitorimit të konsultohet me institucionet përgjegjëse, në mënyrë që të merret këndvështrimi i tyre mbi analizimin e strategjisë dhe gjetjeve që kanë rezultuar. Gjithashtu, raporti mund të konsultohet në forume me grupe të ndryshme të interesit që operojnë në sektorët e mbuluar nga strategjia, apo edhe me qytetarët, ku nëpërmjet takimeve, anketave apo sondazheve shihet se si ata perceptojnë masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë dhe efektivitetin e tyre.

## 9. Publikimi i raportit të monitorimit

---



Raportet e monitorimit të hartuara nga shoqëria civile, duke qenë se janë raporte të pavarura, është e rekomandueshme që të jenë lehtësisht të aksesueshme për qytetarët, si dhe çdo palë të interesuar mbi progresin dhe sfidat e implementimit të dokumentit strategjik.

Gjithashtu, për një kuptueshmëri më të madhe për publikun e gjerë, rekomandohet që pjesë të analizës, gjetjeve apo rekomandimeve të përpunohen duke mundësuar pasqyrimin vizual të të dhënave në infografikë, tabela, kolona, etj.

## 10. Përfshirja në proceset e përmirësimit të dokumenteve strategjike

---



Rezultatet e monitorimit përdoren për të ndërgjegjësuar institucionet në marrjen e masave për përmirësimin e strategjive apo planeve të tyre të veprimit dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit negociator me Bashkimin European.